



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2022:009593

Datë: 29.02.2024

Numri i dokumentit: 05392472

KPPP.nr.1887/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit “Fast” Sh.P.K., me NRB: 70606224, me seli në Kaçanik rruga “Dëshmorët e Lirisë”, kundër debitorit DPH “Art Caffè”, me NRB: 70586274, me seli në Kaçanik, I.R., duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori kundër Urdhrit P.nr.305/2019 të datës 18.12.2019, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Sheremet Livoreka me seli në Kaçanik, jashtë seancës, me datë 27.02.2024, mori këtë:

**AKTVENDIM**

I.APROVOHET në tërësi i bazuar prapësimi i debitorit DPH “Art Caffè”, ashtu që SHFUQIZOHET Urdhri P.nr.305/2019 i datës 18.12.2019, i lëshuar nga Përmbartuesi Privat Sheremet Livoreka.

**A r s y e t i m**

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar Urdhrit P.nr.305/2019 të datës 18.12.2019, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumenteve të besueshme – faturave dhe atë: faturës Nr.072-B të datës 09.12.2014, faturës Nr.079-B të datës 25.12.2014, faturës Nr.020-B të datës 10.04.2015, dhe faturës Nr.027-B të datës 18.04.2015, duke e obliguar debitorin që t’ia paguajë kreditorit borxhin kryesor në vlerë prej 3,854.00 Euro, me kamatëvonesë prej 8 % në vit sipas LMD-së, dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

Kundër Urdhrit të Përmbartuesit Privat, debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim, në të cilin ka theksuar se Përmbartuesi ka vendosur gabimisht kur e ka lejuar urdhrin përmbartimor

duke qenë se këto detyrime debitori i ka përmbushur ndaj kreditorit, dhe për këtë ofrohen dëshmi të pagesës së faturave të cilat janë të përmbushura në tërësi. I ka propozuar gjykatës që të aprovet prapësimi i debitorit, të anulohet urdhri përmbarimor, si dhe të detyrohet kreditori që të paguaj shpenzimet e procedurës përmbarimore, dhe atë në emër të taksës për prapësim shumën prej 20 Euro, dhe në emër të përpilimit të këtij prapësimi shumën prej 104 Euro bazuar në TOAK.

Kreditori, në përgjigje në prapësim, e ka kundërshtuar prapësimin e debitorit si të pabazuar, me arsyetimin se nuk është i faktuar si duhet dhe është jashtë çdo procedure ligjore. Tutje ka theksuar se debitori, propozuesit për përmbarim i detyrohet në shumë totale të borxhit prej 3,854.00 Euro, dhe se debitori Artan Tusha ka pranuar që do t'i kryej obligimet deri më 15.10.2019 në shumë prej 19,888.00 Euro ndërsa ka arritur të bëjë pagesën e 16,034.00 Euro, pjesën tjetër ka rënë në vonesë në shumë prej 3,854.00 Euro. Më tej ka shtuar se si bazë e lëshimit të faturave si në propozim janë fletëdërgesat e mallrave të ndryshme të pranuar nga debitori, duke theksuar se debitori ka paguar një shumë të mjeteve, por nuk i ka paguar të gjitha. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit si i pabazuar, dhe të detyrohet debitori të paguaj shpenzimet e procedurës përmbarimore në tërësi, duke përfshirë edhe përpilimin e kësaj përgjigje në prapësim, në shumën prej 156.00 Euro sipas TOAK-së.

Gjykata Themelore në Ferizaj – dega në Kaçanik, me aktvendimin PPP.nr.137/19 të datës 13.02.2020, e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit “Art Caffè”.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Dytë, me Aktvendimin K.DH.SH.II.nr.248/23 të datës 24.10.2023 e ka aprovuar si të themeltë ankesën e debitorit, dhe sipas detyrës zyrtare e ka anuluar vendimin e shkallës së parë PPP.nr.137/19 të datës 13.02.2020, dhe çështjen e ka kthyer në rivendosje. Kjo gjykatë ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë nuk ka analizuar saktë shkresat e lëndës si dhe nuk e ka vërtetuar gjendjen faktike, dhe e ka udhëzuar që në riprocedurë të bëjë eliminimin e shkeljeve.

Gjykata në rivendosje, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, pretendimeve të kreditorit të paraqitura në përgjigje në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit

69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori i kishte lëshuar debitorit faturën Nr.072-B të datës 09.12.2014, faturën Nr.079-B të datës 25.12.2014, faturën Nr.020-B të datës 10.04.2015, dhe faturën Nr.027-B të datës 18.04.2015, të cilat janë dorëzuar në origjinal së bashku me propozimin për përmbarim.

Gjykata konstaton se borxhi lidhur me faturën Nr.020-B të datës 10.04.2015 në shumën prej 3,042.00 Euro, dhe faturën Nr.027-B të datës 18.04.2015 në shumën prej 2,028.00 Euro, në shumën e përgjithshme në vlerë prej 5,070.00 Euro, është paguar nga debitori, fakt ky i cili vërtetohet nga dëshmitë e pagesave-transferet bankare të cilat janë bashkangjitur në shkresat e lëndës, e që shuma e këtyre pagesave rezulton të jetë më e lartë sesa shuma e kërkuar nga kreditori në propozimin për përmbarim për të gjitha faturat mbi bazën e të cilave ka inicuar propozimin.

Gjykata poashtu vlerëson se Kartela e konsumatorit e bashkangjitur në shkresat e lëndës nuk mund të merret si dokument i besueshëm, ngase nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se një dokument i tillë, bazuar në dispozitën e nenit 29 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të LPP-së, nuk është i përcaktuar si dokument i besueshëm, e për më tepër nuk mund të merret as si provë relavante ngase është dokument i lëshuar njëanshëm nga njëra palë procedurale e cila nuk verifikon në mënyrë të saktë detyrimin e përmbushjes.

Andaj, meqenëse debitori ka përmbushur borxhin që rrjedh nga fatura Nr.020-B e datës 10.04.2015 në shumën prej 3,042.00 Euro, dhe fatura Nr.027-B e datës 18.04.2015 në shumën

prej 2,028.00 Euro, në shumën e përgjithshme në vlerë prej 5,070.00 Euro, dhe meqenëse shuma e këtyre pagesave rezulton të jetë më e lartë sesa shuma e kërkuar nga kreditori në propozimin për përmbarim e cila është 3,854.00 Euro, atëherë rezulton se fatura Nr.072-B e datës 09.12.2014 dhe fatura Nr.079-B e datës 25.12.2014, nuk mund të paraqesin bazë për lejimin e përmbarimit.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

### GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1887/23 me datë 27.02.2024

Gjyqtari

Alajdin Tërshnjaku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2022:009593  
Datë: 29.02.2024  
Numri i dokumentit: 05392472